



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS

[Datë 14.11.2023]

Lënda: Njoftimi i shkurtuar i Kontratës i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike për procedurën e prokurimit me objekt: “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës”

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË
NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia e Tiranës
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tel/Faks: 00 355 4 22 56 799
E-mail: administrative.prokurime@tirana.al
Ueb-faqe www.tirana.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF: 87686-11-14-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës”.

5. Fondi limit: 12,500,000 (dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

- “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës” në programin buxhetor “Investim (231)” me tipologji “Hardware + Software + Punime civile” me vlerë të fondit limit 10,000,000 (Dhjetë milion) lekë pa TVSH.
- “Zhvillimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Infrastrukturës për Ofrimin e Shërbimit Wifi në Ambjentet Publike të Tiranës” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)” me tipologji “Mirëmbajtje” me vlerë të fondit limit 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra (investim edhe mirëmbajtje), pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj. Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës, dhe periudha e implementimit të kontratës është maksimalisht 12 muaj nisur nga kjo datë për realizimin e projektit me të gjithë komponentët përbërës. Periudha e mirëmbajtjes do të jetë 24 (njëzet e katër) muaj, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të projektit (FAZA IV).

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Datë 30/11/2023; Ora: 10.30